

V E N D I M
Nr. 188, datë 15.4.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.113, DATË
26.2.1993 “PËR PËRMIRËSIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS PËR PLOTËSIMIN E
KËRKESAVE TË PËRFAQËSIVE TË HUAJA”**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.113, datë 26.2.1993, pika 6 ndryshohet si vijon:

“Drejtoria e shërbimit të trupit diplomatik, për kryerjen e funksioneve, shfrytëzon burimet e veta financiare nga shërbimet ndaj të huajve dhe burimet financiare nga qiratë, për të realizuar mirëmbajtjen, meremetimin, ndërtimet e reja apo blerjen, brenda e jashtë vendit, të mjediseve të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë diplomatike dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës së trupit diplomatik, shqiptar apo të huaj. Gjithashtu, me burimet financiare të përmendura më sipër drejtoria e shërbimit të trupit diplomatik përballon, tërësisht apo pjesërisht, qiratë e përfaqësive tona jashtë shtetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko